

Pikët Rajonale për Mbështetje të Ndërmarrjeve Sociale – Thirrje për Aplikime

Kriteret për përzgjedhje

Kriteret për përzgjedhje të pikëve rajonale për mbështetje të ndërmarrjeve sociale janë hartuar dhe finalizuar në bashkëpunim me Përfituesin, Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale për tu ndjekur gjatë procesit të vlerësimit për përzgjedhje të **2 pikëve rajonale** në **Ohër** dhe **Veles** të cilëve do u ofrohet mbështetje që do i përshtatet nevojave që kanë, gjatë periudhës së zbatimit të projektit.

Aplikantët që plotësojnë kushtet janë ata që përfaqësojnë njërin nga format e mëposhtme juridike:

- Shoqatë që kryen aktivitete ekonomike
- Fondacion që kryen aktivitete ekonomike
- SH.P.K. (Shoqatë me përgjegjësi të kufizuar) themeluar nga ndonjë shoqëri ose fondacion
- Kooperativë
- Agjenci publike
- Komunë

Kriteret për përzgjedhje dhe rangim:

1. Kapaciteti fizik - Min.5. - Max. 20 pikë

Kandidatët do të përzgjidhen sipas kapacitetit që kanë për të siguruar hapësirë për punë me klientë – ky kriter lidhet me sigurimin e pajisjeve dhe hapësirës për organizim të seancave informative, takimeve dhe trajnimeve me ndërmarrje sociale potenciale dhe ekzistuese. Kandidati potencial duhet të ketë zyrë/ hapësira të pajisura për takime për sesione që do të organizohen në të ardhmen për ndërtim të kapaciteteve.

2. Kapitali njerëzor - Min.5. - Max. 20 pikë

Kandidatët do të përzgjidhen sipas aftësisë që kanë për të ofruar staf dhe kapital njerëzor kompetent për të mbështetur iniciativat ekzistuese për sipërmarrësi sociale. Kandidati potencial duhet të ketë staf të trajnuar dhe kompetent që do të ofrojë seminarë edukativë, trajnime, këshillime individuale dhe këshilla që synojnë rritje të kapaciteteve dhe fuqizimit të ndërmarrjeve sociale, organizatave të shoqërisë civile, kooperativave dhe NMV-ve.

3. Ndërtimi i partneriteteve lokale për inkluzion shoqëror - Min.5. - Max. 20 pikë

Aplikanti duhet të dëshmojë që ka përvojë solide në krijim të partneriteteve lokale dhe nacionale si dhe të shprehë gadishmërinë për të zbatuar aktivitetet e ardhshme në bashkëpunim me partnerë të tjerë siç janë komunat, kompanitë private, OJQ-të etj. dhe duhet të japë kontribut për kohezionin shoqëror në bashkësi përmes ndërtimit të partneriteteve lokale.

4. Qëndrueshmëria organizative dhe financiare - Min.5. - Max. 20 pikë

Aplikanti duhet të dëshmojë që do të ketë qëndrueshmëri financiare pas përfundimit të projektit “Mbështetje për Ndërmarrjet Sociale “ (me anë të së cilit gjenerohen resurse nga shitja e produkteve/shërbimeve, ofrimi i shërbimeve ose iniciativave të mundshme për ndërmarrje shoqërore, përpjekjeve për mbledhje të fondeve për qëndrueshmërinë e pikëve rajonale për mbështetje të ndërmarrjeve sociale në të ardhmen). Është me rëndësi që aplikanti të dëshmojë që ka aftësi të dallojë dhe të mbështesë modele të ndryshme të bizneseve për të siguruar qëndrueshmëri në të ardhmen.

5. Përvoja relevante e Aplikantit - Min.5. - Max. 20 pikë

Aplikanti duhet të dëshmojë që ka përvojë dhe aftësi të përshtatshme, dhe vullnet për të mbështetur ndërmarrjet sociale, OJQ-të, kooperativat, NMV-të. Në këtë drejtim, aplikanti do të përzgjidhet varësisht nga mbështetja që ofron dhe nga numri i subjekteve që mbështet, duke përfshirë këtu edhe numrin dhe llojin e projekteve që janë zbatuar ose që po zbatohen brenda periudhës nga viti 2018 e deri tani.

Procedurat e vlerësimit

- Rezultati maksimal (numri i përgjithshëm i pikëve) për përzgjedhje është 100 pikë
- Intervistohet çdo aplikant që plotëson kushtet
- Lista Finale e 8 kandidatëve do të zgjidhet si pikë rajonale për mbështetje të ndërmarrjeve sociale që do të mbështeten në kuadër të projektit „ Mbështetje për Ndërmarrjet Sociale“
- Vendimi nga Komsioni për Vlerësim: Juria e përbërë nga 5 ekspertë, ku bëjnë pjesë edhe ekspertë nga ekipi i projektit, përfaqësues nga MPPS dhe Rrjeti i NS do të bëjë vlerësimin e aplikacioneve të marra sipas kriterëve vlerësues të përmendura më lartë
- Kandidatëve të zgjedhur do iu dërgohet letër e veçantë për t'i informuar mbi hapat e ardhshëm
- Kandidatëve të zgjedhur do u kërkohet të bëjnë prezantim të shkurtër të subjektit, strukturës dhe aktiviteteve në format prezantimi që bën përshkrim të përgjithshëm

("pitch" format). Gjatë vlerësimit komisioni mund të parashtojë pyetje shtesë lidhur me formularin identifikues. Intervista do të zhvillohet në gjuhën angleze.

Shënim: Kriteret kryesore që pika rajonale për kontakt duhet të ndjekë gjatë punës në të ardhmen lidhur me mbështetjen e iniciativave të ndërmarrjeve sociale përkufizohen sipas definicionit të BE-së:

- Organizata duhet të jetë organizatë e angazhuar me aktivitete ekonomike; pra duhet të merret me aktivitete të vazhdueshme lidhur me prodhim dhe/ose këmbim të mallrave dhe/ose shërbimeve
- Duhet të ketë qëllim eksplicit dhe primar shoqëror; nga i cili përfiton shoqëria
- Duhet të ketë kufizim në shpërndarje të profitit dhe/ose pasurive; qëllimi i kufizimeve të këtilla është prioritetizimi i qëllimit shoqëror mbi përfitimin (profitin)
- Duhet të jetë e pavarur; me autonomi organizative nga Shteti dhe organizata të tjera tradicionale fitimprurëse
- Duhet të ketë qeverisje inkluzive; që karakterizohet nga vendimmarrja pjesëmarrëse dhe/ose demokratike